VENDIM
Nr. 17, datë 30.3.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Elsa Toska	anëtare e Gjykatës Kushtetuese, Kryesuese e seancës		
Fiona Papajorgji	anëtare e	"	"
Altin Binaj	anëtar i	"	"
Përparim Kalo	anëtar i	"	"
Sonila Bejtja	anëtare e	"	"
Marsida Xhaferllari	anëtare e	"	"

me sekretare Enina Kotoni, në datat 25.2.2021 dhe 30.3.2021 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 41 (S) 2017 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: SUZANA SHOTA

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Besnik Mustafaj, Erjon Sejdiaj, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kavajë

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 71 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Marsida Xhaferllari, shqyrtoi pretendimet e kërkueses, e cila kërkoi pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, parashtrimet e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë Vendore Kavajë, të cilat kërkuan pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Suzana Shota dhe shoqëria "Konstruksion F.B." sh.p.k., me ortak dhe administrator subjektin e interesuar, Besnik Mustafaj, kanë qenë palë kundërshtare në një proces gjyqësor civil për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë, të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, pas shqyrtimit gjyqësor, ka dhënë vendimin nr. 2888, datë 12.10.1999 për rrëzimin e padisë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 186, datë 15.2.2001, ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë, ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 460, datë 23.4.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit për pranimin e padisë. Në përfundim të këtij procesi gjyqësor është vendosur detyrimi i shoqërisë "Konstruksion F.B." sh.p.k. të pushojë cenimin e pronësisë ndaj banesës së kërkueses, duke paguar shumën 75,648 USD ($) për dëmin e shkaktuar.

2. Ndërkohë, menjëherë pas dhënies së vendimit nga Gjykata e Apelit Tiranë, kërkuesja ka filluar procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm për vendimin gjyqësor që përmbante detyrimin monetar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 359, datë 19.4.2001, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Zyra e Përmbarimit Kavajë ka regjistruar çështjen në ekzekutim

dhe e ka numërtuar, duke i nxjerrë të gjitha aktet sipas numrit themeltar 248 dhe fraksionit të tij 248/B. Kjo zyrë, me tri vendime të datës 1.6.2001, ka vendosur masën e sekuestros për katër pasuri të paluajtshme (tri apartamente dhe një lokal), të ndodhura në fshatin Kryemedhenj, Golem, të regjistruara në pronësi të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj. Në datën 18.6.2001 është vendosur nga përmbaruesi gjyqësor nxjerrja në ankand e katër pasurive dhe në datën 2.7.2001 fitues të ankandit kanë rezultuar kërkuesja Suzana Shota dhe bashkëshorti i saj. Me vendimin e datës 24.8.2001, Zyra e Përmbarimit Kavajë ka vendosur kalimin e katër pasurive në pronësi të kërkueses dhe bashkëshortit të saj, si dhe ka urdhëruar ZVRPP-në, Kavajë për të kryer regjistrimin.

3. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, pas sekuestrimit të katër pasurive, por përpara zhvillimit të ankandit, konkretisht në datën 6.6.2001, ka paraqitur kërkesëpadi në gjykatë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, duke kërkuar përjashtimin e pasurive të paluajtshme nga sekuestrimi dhe shitja. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 276, datë 13.7.2001, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin, ndër të tjera, se subjekti i interesuar, pas dhënies së vendimit gjyqësor që përmbante detyrim monetar për t'u ekzekutuar prej shoqërisë "Konstruksion F.B." sh.p.k., kishte kryer veprime juridike për tjetërsimin e kuotave të shoqërisë te vëllai i tij në mashtrim të ligjit për t'iu shmangur detyrimit, dhe rrjedhimisht, këto veprime janë nul. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 430, datë 30.7.2001, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi, ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 733, datë 8.7.2002, ka vendosur mospranimin e rekursit.

4. Në datën 30.6.2002 bashkëshortja e subjektit të interesuar, Shpresa Mustafaj, me pretendimin se katër pasuritë ishin fituar gjatë martesës, ka paraqitur kërkesëpadi në gjykatë me objekt përjashtimin nga sekuestroja dhe shitja e pasurive nga Zyra e Përmbarimit Kavajë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 230, datë 5.7.2002, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, që është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 523, datë 30.10.2002. Këto vendime janë ndryshuar nga Gjykata e Lartë, e cila, me vendimin nr. 337, datë 12.2.2004, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke arsyetuar, ndër të tjera, se gjykatat kanë zbatuar keq ligjin, pasi paditë për veçimin e pjesës së bashkëpronarit dhe padia e kërkimit të sendit ngrihen vetëm gjatë fazës së ekzekutimit, fazë e cila në rastin konkret ishte kapërcyer.

5. Në vijim, subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, i është drejtuar sërish gjykatës për të kundërshtuar veprimet përmbarimore për zhvillimin e shitjes në ankand të pasurive dhe për kundërshtimin e vendimit të datës 24.8.2001 të Zyrës së Përmbarimit Kavajë për kalimin në pronësi të apartamenteve në emër të kërkueses. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 390, datë 5.11.2002, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se ajo është parashkruar për shkak të ngritjes së saj jashtë afatit ligjor. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 182, datë 4.3.2003 dhe në vijim, Gjykata e Lartë, me vendimin nr.1010, datë 13.5.2004, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës.

6. Me kërkesë të ZVRPP-së, Kavajë për rikonfirmim të dokumentacionit për shkak të korrigjimit në numrin e pasurive, Zyra e Përmbarimit Kavajë, me vendimin e datës 4.6.2003, ka bërë korrigjimin e vendimit të saj të datës 24.8.2001 dhe ka kërkuar mbajtjen e pasurive në sekuestro për shkak të procesit gjyqësor që po zhvillohej për to. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, e ka kundërshtuar gjyqësisht këtë vendim të përmbaruesit, por Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 552, datë 28.12.2004, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se të drejtat e subjektit të interesuar mbi sendin dhe fatin e tij në qarkullimin civil janë shuar për shkak se sendi ka kaluar në pronësi të kreditorit. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 325, datë 20.6.2005, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi.

7. Ndërkohë që çështja ishte në proces gjyqësor, Zyra e Përmbarimit Kavajë, me vendimin e datës 23.2.2004, ka vendosur refuzimin e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit nr. 359, datë 19.4.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me arsyetimin se veprimet përmbarimore nuk janë kryer ndaj pasurive të shoqërisë debitore "Konstruksion F.B." sh.p.k., por ndaj pasurive të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj. Dy ditë më vonë, me vendimin e datës 25.2.2004, kjo

zyrë ka vendosur heqjen e sekuestros për pasuritë e paluajtshme dhe në vijim, në datën 27.2.2004 ZVRPP-ja, Kavajë ka lëshuar kartelat e pasurisë me shënimet përkatëse në emër të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj.

8. Pas këtyre veprimeve, kërkuesja dhe bashkëshorti i saj kanë kundërshtuar gjyqësisht dy vendimet e përmbaruesit të datave 23.2.2004 dhe 25.2.2004 për refuzimin e ekzekutimit dhe heqjen e sekuestros ndaj pasurive në fjalë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 451, datë 22.10.2004, ka vendosur pranimin e padisë për kërkimin që lidhej me refuzimin e ekzekutimit, ndërsa ka rrëzuar padinë për pjesën që lidhej me heqjen e masës së sekuestros. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 170, datë 4.4.2005, ka vendosur ndryshimin e këtij vendimi, duke e rrëzuar padinë, me arsyetimin se ajo ishte ngritur jashtë afatit ligjor. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1620, datë 25.2.2005, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses dhe bashkëshortit të saj.

9. Nga ana tjetër, ZVRPP-ja, Kavajë në datën 21.6.2004 ka bërë kalimin e katër pasurive në pronësi të kërkueses Suzana Shota dhe bashkëshortit të saj, bazuar në vendimin e datës 24.8.2001 të Zyrës së Përmbarimit Kavajë të nxjerrë nga rezultati i ankandit, duke vlerësuar se ky vendim ishte ende në fuqi.

10. Në të njëjtën datë, më 21.6.2004, kërkuesja dhe bashkëshorti i saj kanë shitur 2 prej pasurive te shtetasi M.L., për të cilin ZVRPP-ja, Kavajë ka lëshuar edhe certifikatat respektive të vërtetimit të pronësisë. Për të njëjtat pasuri kishte lidhur kontrata shitjeje edhe subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, me shtetasin B.K.

11. Në këtë situatë, blerësi prej kërkueses, shtetasi M.L., së bashku me kërkuesen dhe bashkëshortin e saj i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi për rivendikimin e dy pasurive ndaj subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, dhe blerësit prej tij, shtetasit B.K. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 600, datë 9.10.2006, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e shtetasit B.K. t'i dorëzojë shtetasit M.L. pasuritë përkatëse. Në përmbajtje të këtij vendimi gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se: "*gjykata i referohet vendimeve të sipërcituara"*, duke nënkuptuar vendimet nr. 390, datë 15.11.2002 dhe nr. 230, datë 5.7.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë sipas formës përfundimtare të tyre: *"si vendime të formës së prerë, me të cilat është ezauruar pretendimi i të paditurit Besnik Mustafaj se sekuestrimi dhe shitja nuk duhej bërë mbi pronat e tij, por mbi ato të shoqërisë* ..." dhe "*... veprimet juridike për kalimin e pronësisë të kryera nga i padituri Besnik Mustafaj me të paditurit B.K jo vetëm kanë qenë në keqbesim, për të shmangur detyrimet ndaj paditësve Mark Shota e Suzana Shota, por duke mos u regjistruar kontratat e shitjes në ZVRPP-në Kavajë, ato janë të pavlefshme sipas nenit 83 të Kodit Civil.*". Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 510, datë 12.11.2007, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 2079, datë 9.12.2011, ka vendosur mospranimin e rekursit.

12. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, i është drejtuar sërish ZVRPP-së, Kavajë me kërkesë për fshirjen e regjistrimit të pasurisë në emër të kërkueses dhe të subjektit tjetër të interesuar, Erjon Sejdiaj, në zbatim të vendimit të datës 23.2.2004 të Zyrës së Përmbarimit të Rrethit Gjyqësor Kavajë, me të cilin ishte vendosur refuzimi i ekzekutimit dhe heqja e sekuestros (*shih paragrafin 7 të këtij vendimi*). ZVRPP-ja, Kavajë, me vendimin nr. 4, datë 4.5.2010, i është drejtuar kryeregjistruesit, duke kërkuar që regjistrimet në emrin e kërkueses të mos fshihen, me arsyetimin se titulli është ekzekutuar tërësisht dhe se vendimi i kalimit të pasurive në pronësi të kërkueses dhe bashkëshortit të saj nuk është kundërshtuar në rrugë gjyqësore. Kryeregjistruesi, me vendimin nr. 151, datë 12.6.2010, ka vendosur pushimin e procedimit administrativ në zbatim të vendimit nr. 17, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin pas kontrollit kushtetues të disa dispozitave ligjore që lidheshin me regjistrimin e pasurive të paluajtshme, ZQRPP-së i ishte hequr juridiksioni për të trajtuar ligjshmërinë e regjistrimit të pasurive.

13. Në këto kushte, subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, ka kundërshtuar gjyqësisht dy vendimet e mësipërme të regjistruesit dhe të kryeregjistruesit, duke kërkuar regjistrimin e katër pasurive në favorin e tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9631, datë 15.12.2010, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes për shkak të mosparaqitjes pa arsye të

këtij subjekti të interesuar si palë paditëse. Çështja është kthyer për rigjykim, me tjetër trup gjykues, nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 123, datë 5.4.2011.

14. Pas rigjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10824, datë 12.11.2012, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke shfuqizuar dy aktet administrative dhe duke urdhëruar ZVRPP-në të kryejë ndryshimet përkatëse në regjistër në favor të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj. Në vendimin e saj gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se veprimet e kryera nga zyra e përmbarimit janë absolutisht të pavlefshme, pasi janë kryer jo mbi pasuritë e debitorit, shoqëria "Konstruksion F.B." sh.p.k., por mbi pasuritë personale të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj.

15. Mbi apelet e kërkueses dhe të ZQRPP-së, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 4237, datë 19.11.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 10824, datë 12.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Në përmbajtjen e vendimit, kjo gjykatë ka arsyetuar, ndër të tjera, se refuzimi i urdhrit të ekzekutimit nuk mund të bëhet nga përmbaruesi kur titulli është ekzekutuar tërësisht dhe se pretendimet për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, të cilat janë zgjidhur me vendime gjyqësore të formës së prerë, nuk mund të gjykohen sërish.

16. Mbi rekursin e subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se e drejta e subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, për të kërkuar fshirjen buron nga e drejta e tij e pronësisë për katër pasuritë e paluajtshme, të cilat kanë kaluar në kundërshtim të hapur me ligjin në favor të kreditorëve të shoqërisë "Konstruksion F.B." sh.p.k. dhe për këtë shkak të gjitha veprimet përmbarimore janë absolutisht të pavlefshme.

17. Kërkuesja në datën 25.9.2017 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Në datën 30.1.2018, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila prej datës 8.2.2018 nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor, të parashikuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 për shqyrtimin e çështjes konkrete. Me plotësimin e kuorumit, kjo çështje iu nënshtrua bisedimeve nga Mbledhja e Gjyqtarëve, e cila vendosi kalimin e çështjes në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

18. Ndërkohë që çështja ishte në pritje për t'u shqyrtuar në Gjykatën Kushtetuese, me kërkesën e subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10788 akti, datë 17.11.2017, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, sipas ndryshimeve të vendimit nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në vijim të të cilit është bërë edhe regjistrimi i pronave në favor të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj.

19. Në datën 11.5.2018, kërkuesja Suzana Shota dhe bashkëshorti i saj kanë paraqitur sërish kërkesëpadi në gjykatë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore në bazë të urdhrit të ekzekutimit të mësipërm. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. (82-2018-1277) 832, datë 26.12.2018, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se veprimet përmbarimore janë kryer në përputhje me ligjin dhe se nuk cenojnë asnjë të drejtë të palës paditëse, që siç është vërtetuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, nuk janë bërë asnjëherë pronarë të pasurive. Ky arsyetim është bazuar në vendimin nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që kundërshtohet në këtë gjykim kushtetues. Kërkuesja dhe bashkëshorti i saj kanë paraqitur apel dhe çështja është regjistruar në datën 8.11.2019 në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila ende nuk ka dhënë vendim. Për rrjedhojë, ky proces gjyqësor midis palëve nuk është mbyllur me një vendim përfundimtar.

20. Në datën 7.2.2019 është miratuar ligji nr. 111/2018, "Për kadastrën", me të cilin kompetencat e ZQRPP-së dhe ZVRPP-së, Kavajë i kanë kaluar respektivisht Agjencisë

Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë Vendore Kavajë. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi emrat e këtyre institucioneve janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës që është ushtruar kompetenca administrative e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

21. Drejtoria Vendore Kavajë në datën 29.1.2021 ka njoftuar me shkrim se tri prej pasurive janë regjistruar në emër të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, ndërsa pronësia e pasurisë së katërt ka kaluar me kontratë shitblerjeje te dy shtetas të tjerë. Nga kopjet e kartelave të pasurisë konstatohet se këto veprime janë kryer pas dhënies së vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

22. ***Kërkuesja,*** në kërkesën drejtuar Gjykatës*,* pretendon se vendimi gjyqësor i kundërshtuar është dhënë në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës, që garanton të drejtën e procesit të rregullt ligjor, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se janë cenuar:

22.1 *Parimi i sigurisë juridike,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka respektuar *fuqinë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese* dhe ka cenuar, për pasojë, edhe të drejtën e pronësisë. Gjithashtu, siguria juridike është cenuar, pasi Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur në konsideratë se e drejta e pronësisë së kërkueses për pasuritë e paluajtshme ka marrë *fuqinë e gjësë së gjykuar* me procese gjyqësore përfundimtare të mëparshme, që kanë vlerësuar të ligjshme veprimet përmbarimore.

22.2 *Parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi Gjykata e Lartë ka tejkaluar kompetencën ligjore për të vlerësuar pranueshmërinë e rekursit dhe ka vendosur nëpërmjet Kolegjit Administrativ në dhomë këshillimi për themelin e mosmarrëveshjes, duke marrë një kompetencë që ligji ia jep Gjykatës së Lartë vetëm në seancë gjyqësore.

22.3 *E drejta e njoftimit,* pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka shpallur ditën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues për shqyrtimin e rekursit në çështjen gjyqësore, të përfunduar me vendimin e kundërshtuar nga kërkuesja.

23. ***Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj,*** ka paraqitur prapësimet me shkrim, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, si të pambështetur në Kushtetutë dhe në fakte, me argumentet e përmbledhura si vijon:

23.1 Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vlerësuar pavlefshmërinë absolute të veprimeve juridike, që është thelbi i mosmarrëveshjes së rastit konkret, pasi sekuestroja ishte vendosur mbi pasurinë e një personi tjetër dhe jo të debitorit, dhe për këtë shkak shitja në ankand dhe regjistrimi i këtyre pasurive në favor të kërkueses ishin veprime absolutisht të pavlefshme.

23.2 E drejta e pronës së kërkueses nuk është cenuar nga vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, pasi ajo nuk e ka fituar asnjëherë atë në mënyrë të rregullt dhe, për rrjedhojë, kërkuesja nuk legjitimohet në ngritjen e kërkesës së saj. Nëse Gjykata Kushtetuese urdhëron rigjykimin e çështjes nga Gjykata e Lartë, rigjykimi nuk ka asnjë efekt, pasi kërkuesja nuk e ka fituar ndonjëherë të drejtën e pronësisë dhe pavlefshmëria absolute e veprimeve nuk mund të riparohet.

23.3 Parimi i sigurisë juridike nuk është cenuar, pasi vendimi nr. 17, datë 23.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese, ndonëse nuk ka sqaruar llojin e efekteve të tij, ka efekte *ex nunc* dhe, për rrjedhojë, nuk mund të pretendohet mosrespektimi i tij në rastin konkret, ku veprimet për fshirjen dhe regjistrimin e pasurive janë kryer për korrigjimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor. Pranimi i kërkesës nga Gjykata Kushtetuese do të cenonte sigurinë juridike për të drejtat e të tretëve që janë sot pronarë të pasurive të paluajtshme. Gjë e gjykuar në mosmarrëveshjen konkrete nuk përbën e drejta e pronësisë së kërkueses për pasuritë, por e drejta e subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, për të kërkuar fshirjen e kësaj të drejte.

23.4 Veprimet përmbarimore të gabuara ndaj subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, dhe shoqërisë "Konstruksion F.B." sh.p.k. kanë shkelur nenin 11 të Kushtetutës, pasi kërkuesja deri

më sot nuk ka paguar një pjesë të çmimit të blerjes së sendit në ankand. Për rrjedhojë, regjistrimi i pronave në datën 26.6.2004, në favor të saj ka qenë i gabuar.

23.5 Pretendimi për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj bazohet në mendimin e pakicës të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, që ka interpretuar keq ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 dhe ndryshimet ligjore procedurale lidhur me rolin e ri të Gjykatës së Lartë.

23.6 Pretendimi për shkeljen e rregullave të njoftimit nga Gjykata e Lartë nuk është i vërtetë.

24. ***Subjekti i interesuar, Erjon Sejdiaj,*** ndonëse u njoftua rregullisht për zhvillimin e seancave, nuk paraqiti shpjegime me shkrim.

25. ***Subjekti i interesuar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës,*** ka paraqitur shpjegime me shkrim, duke parashtruar se pretendimet e kërkueses janë të bazuara, pasi në mënyrë të përmbledhur janë cenuar:

25.1 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka ngarkuar ZVRPP-në, Kavajë me kompetenca për të fshirë regjistrimet e pasurive të paluajtshme, duke mos respektuar vendimin nr.17, datë 23.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

25.2 *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka në kompetencë me ligj për të disponuar në dhomë këshillimi me vendim për themelin e mosmarrëveshjes.

26. ***Subjekti i interesuar, Drejtoria Vendore Kavajë,*** ka paraqitur shpjegime me shkrim, duke parashtruar se i qëndron pozicionit që ky subjekt ka mbajtur në proceset gjyqësore pranë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, sipas të cilit pretendimet e kërkueses janë të bazuara.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

27. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, ka parashtruar se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vlerësuar pavlefshmërinë absolute të veprimeve juridike, që është thelbi i mosmarrëveshjes midis palëve në këtë gjykim kushtetues.

28. Gjykata vëren se bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", ka në juridiksionin e saj gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se Gjykata Kushtetuese, në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga Kushtetuta, e përcakton vetë juridiksionin e saj gjatë shqyrtimit të çështjeve, rast pas rasti (*shih vendimin nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 63, datë 31.7.2017; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata, duke marrë në konsideratë se kërkuesja ka kërkuar respektimin e zbatimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, vlerësimi i së cilës është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, çmon se pretendimi i subjektit të interesuar është i pabazuar.

B. Për pezullimin e vendimit gjyqësor

30. Kërkuesja, në kërkesën e saj drejtuar Gjykatës, në datën 25.9.2017, ka kërkuar edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë deri sa vendimi i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi. Sipas saj, nga zbatimi i këtij vendimi mund të vijnë pasoja të pariparueshme që cenojnë të drejtën e pronësisë.

31. Mbledhja e Gjyqtarëve, në datën 20.1.2021, pasi mori në shqyrtim shkaqet e parashtruara nga kërkuesja për pezullimin e zbatimit të vendimit, bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 8577/2000,

vlerësoi se në rastin konkret pasojat që vijnë nga vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk mund të konsiderohen të pariparueshme për të drejtën e pronësisë që pretendon kërkuesja. Për më tepër, duke analizuar kohën e gjatë që ka kaluar nga dhënia e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë deri në datën e shqyrtimit të kërkesës për pezullim nga Mbledhja e Gjyqtarëve, në raport me faktin se kërkuesja nuk ka paraqitur më kërkesë ose dokumente shtesë për të argumentuar pasojat negative nga zbatimi i vendimit të kundërshtuar, atëherë këto pasoja nuk mund të konsiderohen se janë reale ndaj interesave të kërkueses, në kuptim të urgjencës që legjitimon caktimin e masës së përkohshme të pezullimit. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur rrëzimin e kërkesës për pezullimin e vendimit.

C. Për legjitimimin e kërkueses

32. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i" dhe pika 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

33. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

34. Gjykata vlerëson se kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin është dhënë vendimi që kundërshtohet në Gjykatën Kushtetuese. Për këtë arsye, pretendimi i subjektit të interesuar se kërkuesja nuk legjitimohet për shkak se ajo nuk e ka fituar rregullisht të drejtën e pronësisë, është i pabazuar. Ajo paraqitet në këtë gjykim kushtetues, para së gjithash, si bartëse e së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi, sipas pretendimeve të saj, i kanë cenuar të drejtën kushtetuese të pronës.

35. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike*, vendimi nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i kundërshtuar nga kërkuesja, është përfundimtar. Për rrjedhojë, në paraqitjen e ankimit kushtetues individual, ajo ka përmbushur edhe këtë kusht paraprak, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës.

36. Gjithashtu, kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis,* pasi vendimi i Kolegjit Administrativ është i datës 7.6.2017, ndërsa kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është depozituar në datën 25.9.2017, pra brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

37. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesja në thelb të kërkesës së saj pretendon se vendimi gjyqësor i kundërshtuar është rezultat i një procesi të parregullt gjyqësor, në drejtim të parimit të sigurisë juridike (në aspektet e mosrespektimit të fuqisë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të parimit të gjësë së gjykuar), të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si dhe të së drejtës së njoftimit. Këto pretendime do të analizohen në vijim nga Gjykata.

Ç. Për themelin e pretendimeve

Ç.1. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike

38. Kërkuesja ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike, duke e parashtruar këtë pretendim në dy aspekte të veçanta. Më konkretisht, ajo pretendon se nuk është respektuar fuqia detyruese e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe fuqia e gjësë së gjykuar.

Ç.1.1 Për mosrespektimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese

39. Kërkuesja ka pretenduar se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar vendimin nr. 17, datë 23.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin janë shfuqizuar

kompetencat e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme për fshirjen e regjistrimeve.

40. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, ka prapësuar se vendimi i Gjykatës Kushtetuese, ndonëse nuk ka sqaruar llojin e efekteve të tij, ka efekte *ex nunc,* dhe, për rrjedhojë, nuk mund të pretendohet mosrespektimi i tij në rastin konkret, ku veprimet për fshirjen dhe regjistrimin e pasurive janë kryer për korrigjimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor.

41. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese që vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi,* eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë *(shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021, nr. 49, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Në çështjen konkrete, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shfuqizimin e akteve administrative të ZQRPP-së dhe të ZVRPP-së, Kavajë, të nxjerra në vitin 2010, duke urdhëruar ZVRPP-në të fshijë regjistrimin e katër pasurive që figuronin në emër të kërkueses Suzana Shota dhe të subjektit të interesuar Erjon Sejdiaj dhe, në vijim, t'i regjistrojë në emër të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj.

Gjykata vëren se vendimi gjyqësor i mësipërm është dhënë nga Gjykata e Lartë pas vendimit nr. 43. 17, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin u shfuqizua neni 10, paragrafi i dytë dhe paragrafi i tretë, i ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën, duke i hequr zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme juridiksionin për të trajtuar ligjshmërinë e regjistrimit të pasurive. Nga ana tjetër, në arsyetimin e vendimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shprehet: "*Bëhet fjalë për një regjistrim dhe kërkesë për çregjistrim jo mbi bazën e meritave të pasjes ose jo të titullit të pronësisë, e cila do të bënte që veprimi të ishte ushtrim i një atributi gjyqësor për të cilën është shprehur Gjykata Kushtetuese, duke shfuqizuar nenin në fjalë, por bëhet fjalë për çregjistrimin e një vendimi i cili është pasojë e një gabimi që është bërë nga vetë përmbarimi, i cili pas njohjes me faktet ka revokuar urdhrin e tij dhe në këto kushte, administrata e ZRPP-së dhe Kryeregjistruese, thjesht duhet të pasqyrojë në regjistër ndryshimet që nënkuptonte një gjë të tillë.".*

44. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë të gjitha proceset gjyqësore të zhvilluara midis palëve, vëren se është e qartë që nuk bëhet fjalë për procedurë korrigjimi gabimesh prej zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pasi vetë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij ka shqyrtuar dhe vlerësuar titujt e pronësisë së palëve, duke vendosur se e drejta e pronësisë i takon subjektit të interesuar dhe për këtë shkak zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme duhet të procedojë me çregjistrimin e pasurive në emër të kërkuesve dhe, në vijim, me regjistrimin e tyre në favor të subjektit të interesuar. Për pasojë, pretendimi i subjektit të interesuar se vendimi nr. 17, datë 23.4.2010, nuk zbatohet në çështjen konkrete është i pabazuar, sepse në kohën e dhënies së vendimit nga Gjykata Kushtetuese, procesi gjyqësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis palëve ishte ende në zhvillim e sipër, pra i papërfunduar.

45. Për sa më sipër, Gjykata çmon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar fuqinë detyruese të vendimit nr. 17, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese, për rrjedhojë pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike në këtë aspekt është i bazuar.

Ç.1.2 Për mosrespektimin e gjësë së gjykuar

46. Kërkuesja ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi nuk ka mbajtur në konsideratë fuqinë e gjësë së gjykuar me vendimin nr. 276, datë 13.7.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

47. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, ka prapësuar se pranimi i kërkesës nga Gjykata Kushtetuese do të cenonte sigurinë juridike për të drejtat e të tretëve që janë sot pronarë të

pasurive të paluajtshme, që janë objekti material i mosmarrëveshjes së palëve.

48. Gjykata Kushtetuese e ka vlerësuar gjënë e gjykuar si pjesë të sigurisë juridike dhe të lidhur me procesin e rregullt. Mosrespektimi i gjësë së gjykuar shkakton cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra cenon vetë sigurinë juridike. Në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, atëherë asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 50, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 19.4.2013; nr. 23, datë 8.6.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese ka pohuar se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që ato të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008, të Gjykatës Kushtetuese).*

50. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesja Suzana Shota dhe subjekti i interesuar Besnik Mustafaj, përveç procesit gjyqësor të përfunduar me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që është objekt kundërshtimi në këtë gjykim, janë përfshirë edhe në shtatë procese të tjera gjyqësore, për shkak të mosmarrëveshjeve për katër pasuri të paluajtshme, që kanë lindur nga procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor nr. 186, datë 12.10.1999, të Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin shoqëria "Konstruksion F.B." sh.p.k. detyrohej të përmbushte detyrimin në të holla ndaj kërkueses Suzana Shota për shkak të cenimit të së drejtës së saj të pronësisë.

51. Katër prej këtyre proceseve gjyqësore janë përfunduar me vendime, të cilat kanë rrëzuar pretendimet e palëve për shkaqe procedurale që lidheshin me afatet e ngritjes së padive ose shuarjen e së drejtës materiale të palëve (*shih paragrafët 4–6 dhe 8 të këtij vendimi*), që nënkupton se vendimet gjyqësore respektive, ndonëse janë bërë përfundimtare në pikëpamje të procedurës së shqyrtimit të ankimeve deri në gjykatat më të larta, ato nuk kanë fuqinë e gjësë së gjykuar për të drejtat e pronësisë të pretenduara nga palët, pasi gjykata nuk ka vlerësuar themelin e mosmarrëveshjes.

52. Një proces tjetër gjyqësor, i vënë në lëvizje nga kërkuesja dhe bashkëshorti i saj, me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbarimore të kryera për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, sipas ndryshimeve me vendimin nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, është ende në zhvillim e sipër në Gjykatën Administrative të Apelit. Në këtë gjykim, i cili ende nuk ka përfunduar, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. (82-2018-1277) 832, datë 26.12.2018, ka vendosur rrëzimin e padisë me arsyetimin, ndër të tjera, se kërkuesja dhe bashkëshorti i saj, siç është vërtetuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, nuk janë bërë asnjëherë pronarë të pasurive. Në nxjerrjen e këtij konkluzioni gjykata e shkallës së parë i është referuar gjykimit të përfunduar me vendimin nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Gjykatës së Lartë, që kundërshtohet në këtë gjykim kushtetues *(shih paragrafin 19 të këtij vendimi).*

53. Situata paraqitet e ndryshme te dy proceset e tjera gjyqësore. Konkretisht, në procesin gjyqësor të vitit 2001, të vënë në lëvizje nga subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, është vlerësuar me vendim gjyqësor përfundimtar se veprimet përmbarimore për nxjerrjen në ankand dhe shitjen e katër pasurive të paluajtshme, me qëllim plotësimin e detyrimit në të holla, ishin të ligjshme (*shih paragrafin 3 të këtij vendimi*). Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi është përcaktuar, ndër të tjera, se subjekti i interesuar, pas dhënies së vendimit gjyqësor që përmbante detyrim në të holla për t'u ekzekutuar prej shoqërisë "Konstruksion F.B." sh.p.k., kishte kryer veprime juridike për tjetërsimin e kuotave të shoqërisë te vëllai i tij në mashtrim të ligjit, për t'iu shmangur detyrimit dhe, rrjedhimisht, këto veprime janë nul.

54. Po ashtu, në procesin gjyqësor të vitit 2006, të vënë në lëvizje prej kërkueses, është vlerësuar me vendim gjyqësor përfundimtar e drejta e pronësisë për dy prej pasurive të

paluajtshme. Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi gjykata është shprehur se pretendimi i subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, se sekuestrimi dhe shitja nuk duhej bërë mbi pronat e tij, por mbi ato të shoqërisë, është shqyrtuar më parë me vendime gjyqësore të formës së prerë. Po ashtu, gjykata është shprehur se veprimet juridike për tjetërsimin e pasurive nga subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, te persona të tretë kanë qenë në keqbesim dhe të pavlefshme (*shih paragrafin 11 të këtij vendimi*).

55. Gjykata, paraprakisht analizës së vendimit gjyqësor të kundërshtuar, në raport me standardet kushtetuese të mësipërme, vlerëson se nuk qëndron argumenti i subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, se shfuqizimi eventual i vendimit gjyqësor të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë do të cenojë sigurinë juridike për të drejtat e të tretëve që janë sot pronarë të pasurive të paluajtshme. Të drejtat e të tretëve janë të ndërvarura nga të drejtat e palëve në proces, objekt i këtij gjykimi kushtetues, por legjislacioni në fuqi ka mjete efektive në dispozicion për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tilla, rregullimin e pasojave dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

56. Nga analiza e vendimit nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që kundërshtohet në këtë gjykim kushtetues, Gjykata konstaton se Kolegji Administrativ ka arsyetuar se e drejta e paditësit për të kërkuar fshirjen buron nga e drejta e tij e pronësisë për katër pasuritë e paluajtshme, të cilat kanë kaluar në kundërshtim të hapur me ligjin në favor të kreditorëve të shoqërisë "Konstruksion F.B." sh.p.k. dhe për këtë shkak të gjitha veprimet përmbarimore janë absolutisht të pavlefshme. Në arsyetimin e këtij vendimi konstatohet se nuk janë parashtruar si fakte dy proceset gjyqësore të vitit 2001 dhe vitit 2006, midis palëve ndërgjyqëse, që kanë vlerësuar dhe vendosur për të drejtën e pronësisë për pasuritë e paluajtshme dhe ligjshmërinë e veprimeve përmbarimore. Për më tepër, ndonëse Gjykata Administrative e Apelit ka përdorur gjënë e gjykuar si një prej argumenteve kryesore për rrëzimin e padisë dhe subjekti i interesuar në rekursin e tij e ka kundërshtuar këtë argument shprehimisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit dhe ka heshtur nëse në rastin konkret zbatohej ose jo koncepti i gjësë së gjykuar.

57. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka urdhëruar fshirjen e regjistrimit të pasurive në emër të kërkuesve, me arsyetimin se e drejta e pronësisë së tyre ishte fituar në kundërshtim me ligjin, ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi nuk ka respektuar fuqinë e gjësë së gjykuar.

Ç.2. Për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

58. Kërkuesja ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi nuk ka zbatuar dispozitat ligjore për procedurën dhe llojin e vendimmarrjes në dhomë këshillimi, për shkak të ndryshimeve kushtetuese të kompetencave të Gjykatës së Lartë të vitit 2016.

59. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, ka prapësuar se pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i pabazuar, pasi bazohet në mendimin e pakicës të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, që ka interpretuar keq ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 dhe ndryshimet ligjore procedurale lidhur me rolin e ri të Gjykatës së Lartë.

60. Gjykata vëren se me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 kompetencat e Gjykatës së Lartë janë reformuar, duke përfshirë tashmë në juridiksionin e saj vetëm shqyrtimin e çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin, zhvillimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit (neni 141 i Kushtetutës). Për shkak të delegimit që neni 141 ka bërë te ligji, Kuvendi ka miratuar ndryshimet ligjore të nevojshme për zbatimin e kompetencave të reja kushtetuese të Gjykatës së Lartë. Në këtë kuadër është miratuar edhe ligji nr. 39/2017 (hyrë në fuqi në datën 21.4.2017), me të cilin është amenduar ligji nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar *(ligji nr. 49/2012)*. Këto ndryshime kanë përcaktuar regjim tranzitor të ndryshëm për çështjet në proces, pasi në nenin 11 të ligjit nr. 39/2017 parashikohet: *"Çështjet aktualisht në gjykim në Gjykatën e Lartë do të vazhdojnë të gjykohen sipas ligjit në fuqi, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji."*. Me

këtë bazë ligjore, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjatë gjykimit ka zbatuar dispozitat e ligjit nr. 49/2012, përpara ndryshimeve, pasi çështja konkrete u regjistrua në Gjykatën e Lartë, bazuar në rekursin e depozituar në datën 18.12.2014.

61. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar.

Ç.3. Për cenimin e së drejtës të njoftimit

62. Kërkuesja ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën e saj të njoftimit, pasi, në shkelje të ligjit, nuk ka shpallur ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues. Sipas kërkueses, në shqyrtimin e çështjes së saj ka munguar shpallja publike, pasi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në rubrikën *"Lista e çështjeve administrative për gjykim, datë 7.6.2017",* e shpallur në datën 17.5.2017, nuk është publikuar çështja objekt kundërshtimi.

63. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, ka prapësuar se pretendimi i kërkueses për shkeljen e rregullave të njoftimit nuk është i vërtetë, pasi njoftimet kryhen nga Gjykata e Lartë përmes afishimit në ambientet e kësaj gjykate.

64. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se megjithëse në shqyrtimin e çështjeve administrative Gjykata e Lartë, përgjithësisht, procedon me shqyrtimin jo në seancë publike me praninë e palëve, por në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, kjo nuk nënkupton se ky lloj gjykimi përjashton detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve në mënyrë që të mbrohen në procesin gjyqësor ku janë palë me anë të paraqitjes së komenteve ose prapësimeve lidhur me pretendimet e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën. Qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme (*shih vendimet nr. 59, datë 16.9.2016; nr. 29, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

65. Në çështjen konkrete, ashtu siç prapëson subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, Gjykata vëren se pretendimi i kërkueses nuk është i vërtetë. Kërkueses i është komunikuar rekursi dhe ka marrë dijeni në datën 31.1.2015, me anë të dëftesës së komunikimit të rekursit, duke iu krijuar mundësia për të paraqitur parashtrimet e saj lidhur me shkaqet e rekursit të paraqitur nga subjekti i interesuar. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se në përputhje me nenin 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, çështja është publikuar në shpalljet e datës 10.5.2017, duke njoftuar se seanca do të zhvillohej në dhomë këshillimi në datën 31.5.2017, në orën 09:15. Sipas informacionit për përfundimin e seancave të çështjeve administrative të datës 31.5.2017 ka rezultuar se është vendosur shtyrja e seancës për në datën 7.6.2017, sërish në dhomë këshillimi. Nga materialet e dosjes së Gjykatës së Lartë (procesverbali i seancës gjyqësore të datës 7.6.2017) rezulton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur se palët kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit procedural me anë të shpalljes publike.

66. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar është haptazi i pabazuar.

67. Si përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkueses Suzana Shota lidhur me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të mosrespektimit të fuqisë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të fuqisë së gjësë së gjykuar, është i bazuar, për rrjedhojë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 30.3.2021.

Shpallur më 26.4.2021.

Anëtarë: Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Përparim Kalo